

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. SOKOL BINAJ

05/20/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 17.05.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Binaj, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 20.05.2019 vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Sokol Binaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda .

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Firdes Shuli, znj. Pamela Qirko relatores, znj. Etleda Çiftja anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.